



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:183604

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05639623

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal,** me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku, dhe zyrtaren ligjore Ardita Tasholli, në çështjen penale ndaj të pandehurit E.S. me vendbanim në rrugën "...", komuna Shtime për shkak të veprës penale në vazhdim Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1057/23 të datës 30.08.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, i cili është mbajtur më datë 29.04.2024 në të cilin morën pjesë prokurori i shtetit Egzon Jakupi prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, përfaqësuesja e palës së dëmtuar KEDS distrikti në Ferizaj, T.K. si dhe i pandehuri E.S., pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit më datë 29.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 30.04.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**E.S.** nga i ati I., e ëma R., i lindur më datë ..., në Shtime, ku dhe jeton në rrugën "...", me numër personal ....., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, punëtor fizik, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**Sepse**

Nga data 29.05.2020 e deri me datën 25.01.2021 në rrugën "...", në Shtime, përkatësisht në shtëpinë e tij, i pandehuri në vazhdim me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën, në atë mënyrë që gjatë kontrollit të bërë nga zyrtarët e kompanisë " KEDS " rezulton

se i pandehuri shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë të kundërligjshme, pasi është hasur në lidhje direkte jashtë pikës matëse duke bërë anashkalimin e matjes së energjisë elektrike të shpenzuar me ç'rast ndërmarrjes KEDS-ë Distrikti në Ferizaj i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 412.03 euro.

- Me këtë ka kryer veprën penale në vazhdim **Vjedhja e shërbimeve** nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 17, 21, 38, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70, dhe 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 452, 455 paragrafi 1 dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të pandehurin e:

## G J Y K O N

- I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë euro) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht.
- II. Obligohet i pandehuri E.S. që në emër të kërkesës pasurore juridike të dëmtuarës KEDS - Distrikti Ferizaj, lidhur me kompensimin e dëmit t'ia paguaj shumën në vlerë prej 412.03 Euro (katër qind e dymbëdhjetë euro e tre cent), të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në 8 këste të barabarta nga 51.50 (pesëdhjetë e një euro e pesëdhjetë cent) në afat brenda 8 muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- III. I pandehuri lirohet nga pagesa e shpenzimeve procedurale, andaj shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

## A R S Y E T I M

### **1.Rrjedha e çështjes**

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm më datë 30.08.2023 ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1057/23 kundër të pandehurit E.S. për shkak të veprës penale në vazhdim Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Me datë 29.04.2024 pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit Egzon Jakupi, përfaqësuesja e të dëmtuarës KEDS distrikti në Ferizaj, T.K. si dhe i pandehuri E.S..

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 paragrafi 2 dhe 6 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësinë nga ana e të pandehurit.

## **2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë**

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore të cilat kërkohen me nenin 242 paragrafi 2 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve të cilat ishin prezentë.

Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit dhe i njëjti nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë. Pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: Deklarata e të pandehurit e dhënë në prokurori me datë 29.08.2023, procesverbali me numër ... i datës 23.10.2018, fatura DFEH... e datës 27.03.2020, procesverbali me numër ... i datës 26.03.2020, fatura DFEH... e datës 05.02.2020, procesverbali me numër ... i datës 29.01.2020, fatura DFEH... e datës 30.04.2020, kalkulimi RH me ID e rastit ... i datës 30.04.2020, procesverbali me numër ... i datës 29.04.2020, fatura DFEH... e datës 01.06.2020, kalkulimi RH me ID e rastit ... i datës 01.06.2020, procesverbali me numër ... i datës 29.05.2020, kalkulimi RH me ID e rastit ... i datës 30.07.2020, procesverbali me numër ... i datës 30.07.2020, fatura DFEH... e datës 28.01.2021, kalkulimi RH me ID e rastit ... i datës 28.01.2021, procesverbali me numër ... i datës 25.01.2021, fatura DFEH... e datës 04.12.2020, kalkulimi RH me ID e rastit ... i datës 04.12.2020, procesverbali me numër ... i datës 02.12.2020, fatura DFEH... e datës 05.10.2020, fatura DFEH... e datës 05.10.2020, procesverbali me numër ... i datës 03.10.2020, 8 (tetë) fletë të formatit A4 me fotografi si dhe shkresat e tjera që gjenden në

lëndë, po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### **3.Gjendja faktike e vërtetuar**

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri E.S. ka kryer veprën penale në vazhdim Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë euro) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë: pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, është hera e parë që kryen vepër penale, faktin se i njëjti është përndarë për veprën penale që e ka kryer dhe ka kërkuar falje publike, i gjendjes së dobët ekonomike, mbajtës i familjes, si dhe premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, kurse rrethana rënduese nuk gjeti.

Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht përveç tjerash gjykata pati parasysh edhe qëllimin e dënimit me kusht e që në nenin 47 të KPRK-së përcaktohet se qëllimi i dënimit me kusht është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale. Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së e që konsistojnë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e

shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### **5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike**

Neni 462 paragrafi 2 i KPP-së përcakton se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mblledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi”*. Pasi që vlera e dëmit ishte e përcaktuar saktë, gjykata vendosi që pagesa e shumë s të lartcekur të bëhet me këste ashtu siç është e përcaktuar ne pikën 2 të diapozitivit të këtij aktgjykimi duke marrë parasysh gjendjen ekonomike të pandehurit dhe kërkesën e tij të bërë në shqyrtim fillestar që kompensimi i dëmit ti mundësohet të bëhet me këste duke pasur parasysh gjendjen e dobët financiare të pandehurit.

### **6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale**

Neni 452 paragrafi 4 i KPP-së përcakton se: *“Në vendimin me të cilin vendoset për shpenzimet, gjykata mund ta lirojë të pandehurin nga detyrimi i kompensimit, në tërësi ose pjesërisht, të shpenzimeve të procedurës penale nga neni 449, paragrafit 2, nën-paragrafët 2.1 deri në 2.6, dhe nën-paragrafit 2.9 të këtij Kodi, nëse pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit ose të personave që ai detyrohet t'i mbështesë materialisht. Kur këto rrethana konstatohen pas marrjes së vendimit lidhur me shpenzimet, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues me aktvendim të posaçëm mund të lirojë të pandehurin nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale ose t'i lejojë që ato t'i paguajë me këste”*. Andaj gjykata duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore si dhe në gjendjen e rëndë ekonomike të të pandehurit, i njëjti është përfitues i pensionit për personat e zhdukur e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale departamenti për familjet e dëshmorëve me numër ... e datës 01.10.2014 në emër të R.R.S. (nëna e të pandehurit e cila jeton në bashkësi familjare) me vendim të datës 17.11.2014, andaj në rast se të njëjtit do ti ngarkoheshin shpenzimet e procedurës do t'i vështirësohej ekzistenca materiale, gjykata vendosi që të njëjtin ta lirojë nga pagimi i shpenzimeve të procedurës penale.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**2023:184050; më datë 30.04.2024**

**Zyrtarja ligjore,**  
Ardita Tasholli

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Dardan Maloku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.